



Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

MAJ 2023

Agjencia ka marrë masa dhe ka siguruar kushtet për të zbardhur dhe administruar ankesat e ardhura në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga publiku, si dhe ankesa e shqetësime të adresuara nëpërmjet institucioneve të tjera të administratës publike apo nga media vizive dhe ajo e shkruar.


Të gjitha ankesat e reja regjistrohen në Sistemin e Menaxhimit të Çështjes, për t'u ndjekur në vijim, në kohë reale, në përputhje me ligjin dhe procedurat standarde të punës për trajtimin e ankesave.

MËNYRAT E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

Për ankesa ndaj strukturave objekt i veprimtarisë



ankesa@amp.gov.al



0800 90 90

Për denoncime në kuadër të Vetingut në Polici



denonco@amp.gov.al



Rr. "Asim Vokshi", Nr. 19/1, Tiranë


Për t'u paraqitur në zyrat tona



Zyra e Pritjes së Qytetarëve në
Drejtorinë e Përgjithshme

Zyrat e Drejtorive Rajonale pranë
DVP-ve në Qarqe

Për t'u informuar rreth AMP, na ndiqni



www.amp.gov.al



VEPRIME HETIMORE

Referimet e bëra në Prokurori

21 referime në Prokurori për 28 punonjës të Policisë së Shtetit dhe 6 shtetas, si të dyshuar për vepra të ndryshme penale.

Arrestuar/ndaluar në flagrancë

4 punonjës policie të arrestuar në flagrancë

Ekzekutimet e vendimeve të dhëna nga Prokuroria/Gjykata

Vendosur caktimi i masës ndaluese "Arrest në burg":

1 punonjës policie dhe 1 shtetas

INSPEKTIVE/VENDIME

Gjatë muajit Maj janë kryer 5 inspektive të paplanifikuara, të iniciuara nga ankesat e qytetarëve, të cilat i janë nënshtruar hetimit administrativ dhe ankuesit i është kthyer përgjigje mbi përfundimet e inspektimit.

Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar për muajin Maj në total 15 praktika disiplinore, nga të cilat në 10 raste ka konstatuar dhe vendosur fillimin e hetimit disiplinor për 21 punonjës policie, ndërsa në 5 raste ka konstatuar dhe vendosur mosfillimin e hetimit disiplinor, si më poshtë:

- Në 1 rast, për 1 punonjës policie, Komisioni Disiplinor ka vendosur dhënien e masës disiplinore "Përfundim nga Policia e Shtetit".
- Në 1 rast, për 3 punonjës policie, Komisioni Disiplinor ka vendosur përfundimin e hetimit disiplinor pa shkelje administrative.
- Në 8 raste, për 17 punonjës policie, Komisioni Disiplinor ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor për "Shkelje të rëndë".
- Në 3 raste, për 7 punonjës policie, Komisioni Disiplinor ka vendosur mosfillimin e hetimit disiplinor pasi shkelja e disiplinore e kryer nuk është konstatuar nga veprimtaria e AMP dhe për punonjësit e policisë ka nisur hetimi disiplinor nga Drejtoria e Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit.
- Në 2 raste, për 2 punonjës policie, Komisioni Disiplinor ka vendosur mosfillimin e hetimit disiplinor pasi nuk ka konstatuar shkelje administrative.

HETIME ADMINISTRATIVE TË ANKESAVE

Zyra e pritjes së qytetarëve dhe komunikimi me publikun




317 Telefonata

në linjën e gjelbër 08009090, nga të cilat:

140 telefonata brenda objektit të veprimtarisë së AMP (Në ndjekje nga strukturat përgjegjëse të Agjencisë)

68 telefonata jashtë objektit të veprimtarisë së AMP (Adresuar strukturave të administratës publike për ndjekje)

109 telefonata i është dhënë informacioni sipas rastit (Qytetarët janë orientuar drejt strukturës kompetente të administratës publike që trajton ankesat e tyre)



Ankesa të trajtuara

130 ankesa

- Në 22 raste, ankesat e qytetarëve kanë qenë të drejta
- Në 83 raste, ankesat e qytetarëve kanë qenë të pabazuara
- Në 25 raste, ankesat e qytetarëve nuk provohen



Ankesa të administruara

Administrimi nënkupton regjistrimin e çdo ankese, pavarësisht nëse duhet të ndiqet nga Agjencia apo një institucion tjetër i Administratës Publike. Ankesat administrohen në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave, ku secila merr një numër unik.

129 ankesa